

Statistikat e Bujqësisë 2020

Tiranë, më 25 Qershor 2021: Në vitin 2020, prodhimi i perimeve është 1.295.726 tonë, duke shënuar rritje vjetore me 2,99 %, krahasuar me vitin 2019. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 506.531 tonë, Berat me 131.735 tonë dhe Tiranë me 130.001 tonë.


Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë tonë)

Prodhimi bujqësor	2016	2017	2018	2019	2020
Bimët e arave					
Drithëra	698,4	701,7	678,2	666,1	684,0
Perime	1.129,1	1.151,9	1.166,3	1.258,0	1.295,7
Patate	238,3	249,8	254,5	260,7	254,8
Fasule	25,0	21,2	24,5	24,8	25,8
Bimë industriale	-	32,7	30,8	33,7	30,1
Bimë medicinale	10,6	12,8	12,5	12,9	14,4
Foragjere	6.144,0	6.688,6	7.050,1	7.115,2	7.170,5
Drufrutorët					
Pemë frutore	261,0	262,6	274,3	272,6	273,7
Ullinj	99,0	107,8	117,6	98,3	131,9
Agrume	40,0	41,0	45,5	46,9	49,2
Rrush	205,1	202,9	184,8	189,9	199,1

Prodhimi i drithërave në vitin 2020 është 684.023 tonë, duke shënuar rritje me 2,61 %, në krahasim me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të drithërave u arrit në qarkun e Fierit me 170.229 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 99.858 tonë dhe Korçë me 78.801 tonë.


Në vitin 2020, prodhimi i patates është 254.886 tonë, duke u ulur me 2,22 %, në krahasim me vitin 2019. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit të patates në vend janë, Korça me 59.316 tonë, Fieri me 50.146 tonë dhe Elbasani me 28.684 tonë.

Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patates (mijë tonë)



Perimet e njoma përfaqësojnë 67,52 % të perimeve gjithsej ndjekur nga bostanoret me 23,07 % dhe perimet e thata me 9,41 %.

Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve, 2020 (në %)




Në vitin 2020, u prodhuan 874.947 tonë perime të njoma duke shënuar rritje prej 5,07 %, ndërsa prodhimi i bostanoreve dhe perimeve të thata kanë pësuar një ulje të lehtë, respektivisht 0,51 % dhe 2,38 %, krahasuar me vitin 2019.

Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 35,79 %, kastravec 12,99 % dhe speci 11,78 %. Në perimet e thata, qepa e thatë përfaqëson 85,59 % ndaj prodhimit gjithsej, ndërsa në prodhimin e bostanoreve shalqini përfaqëson 83,22 % të prodhimit.

Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 21,81 % të prodhimit gjithsej të perimeve nga ku 50,86 % e këtij prodhimi i përket Qarkut Fier.

Në vitin 2020, prodhimi në serra është rritur me 5,18 %, krahasuar me një vit më parë, qarku me përqindjen më të lartë të prodhimit të perimeve në serra ndaj prodhimit të perimeve gjithsej është Berati me 64,81 % dhe Fieri 28,37 %, përqindja më e ulët është shënuar në qarkun Korçë dhe Dibër me 0,16 % dhe 0.35 %.


Fig. 3 Prodhimi i perimeve në fushë dhe serrë, sipas qarqeve 2020 (në %)



Drufrutorët

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit.


Fig. 4 Prodhimi i drufrutorëve (mijë tonë)



Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2020 është 273.749 tonë. Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore u arrit në qarkun e Korçës me 82.007 tonë pasuar nga qarqet Elbasan me 38.470 tonë dhe Fier me 33.829 tonë.

Grupi i pemëve frutore me farë zë 44,41 % të prodhimit, peshën kryesore në këtë grup e zë prodhimi i mollëve me 84,03 %. Qarku i Korçës zë 83,14 % të prodhimit të mollëve gjithsej në vend.

Fig. 5 Struktura e prodhimit të pemëve frutore sipas llojeve dhe qarqeve, 2020



* Përfshihet prodhimi i manave dhe të tjera

Në grupin e pemëve frutore me bërthamë, peshën më të madhe e zënë prodhimi i kumbullave me 47,55 % të prodhimit të këtij grupi, pasuar nga pjeshkët me 23,25 % dhe qershitë me 23,34%.

Në grupin e pemëve frutore subtropikale, peshë kryesore zë prodhimi i fiqve me 50,34 % pasuar nga shegët me 16,15 %.

Prodhimi më i lartë për pemët frutore arrore është shënuar në Qarkun e Kukësit, peshën kryesore e zënë arrat me 43,69 %, pasuar nga gështenjat me 37,46 %.

Në vitin 2020, u prodhuan 131.971 tonë ullinj, duke shënuar rritje me 34,24 % krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të ullirit u arrit në qarkun e Fierit me 35.854 tonë pasuar nga qarqet Berat me 33.082 tonë dhe Elbasan me 22.764 tonë. Varietet e ullirit për vaj përfaqësojnë 82,22 % të prodhimit total dhe varietet e ullirit për tavolinë përfaqësojnë 17,78 %.

Prodhimi i agrumeve në vitin 2020 është 49.201 tonë me një rritje prej 4,95 %, krahasuar me një vit më parë, ku 65,36 % të prodhimit gjithsej të agrumeve e zënë mandarinat. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve është shënuar në qarkun e Vlorës me 66,05 % (32.497 tonë).

Në 2020, prodhimi i rrushit është 199.070 tonë duke shënuar një rritje me 4,83 %, krahasuar me një vit më parë, ky prodhim përfaqësohet nga rrushi i vreshtave me 59,68 % dhe rrushi i pjergullave me 40,32 %.

Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2020 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore dhe blegtorale është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Të dhënat për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Përkufizime

Tokë e punueshme

Toka e punueshme është toka arë e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose renditje të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Normalisht, kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vitesh.

Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Këto kultura kryesore, normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit. Kulturat kryesore janë drithrat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Viti i prodhimit

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Drufrutorët

Drufrutorët përfaqësohen nga pemët frutore (frutat farore, bërthamore, subtropikale, arvore e tjera), ullinjte, agrumet, vreshtat dhe pjergullat.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmytyjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve.

Serrë

Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

Sipërfaqja prodhuese

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përjashtohen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.